

Statistikat e Pyjeve 2021

Tiranë më 09 Shtator 2022: Në vitin 2021 fondi pyjor dhe kulloror i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.716.824 (ha) duke përfaqësuar 59,7 % të sipërfaqes gjithsej të vendit.

Tab.1 Bilanci Kadastral i Fondit Pyjor dhe Kulloror të Shqipërisë


| Viti | Pyje | | Kullota | | Sipërfaqe me bimësi pyjore dhe inproduktive | | Gjithsej | |
|------|-----------|------|---------|------|---|------|-----------|-----|
| | Sip.Ha | % | Sip.Ha | % | Sip.Ha | % | Sip.Ha | % |
| 2019 | 1.051.843 | 60,4 | 478.081 | 27,5 | 210.382,5 | 12,1 | 1.740.307 | 100 |
| 2020 | 1.051.841 | 60,4 | 478.081 | 27,5 | 210.382,1 | 12,1 | 1.740.304 | 100 |
| 2021 | 1.146.724 | 66,8 | 448.750 | 26,1 | 121.350,5 | 7,0 | 1.716.824 | 100 |

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Në 2021 pyjet shtrihen në një sipërfaqe 1.146.724 (ha) që përfaqëson 66,8 % të fondit pyjor dhe kulloror. Kullorat dhe livadhet zenë një sipërfaqe 448.750 (ha) ose 26,1 % të fondit pyjor dhe kulloror. Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe joproduktive që janë pjesë e fondit pyjor zenë një sipërfaqe 121.350 (ha) ose 7,0 % të këtij fondi.


Në vitin 2021, janë përfshirë edhe sipërfaqet e pyjeve që ndodhen në zonat e mbrojtura dhe si rezultat ka një rritje prej 94.882 ha, krahasuar me vitin 2020.

Fig. 1 Sipërfaqja e Fondit Pyjor dhe Kulloror (000/ha)



Në vitin 2021, vëllimi i përgjithshëm i pyjeve, arrin në rreth 54.963.150 (m³), nga të cilat 94,0 % e këtij vëllimi përbëhet nga pyjet publike dhe 6,0 % nga pyjet private. Në vitin 2021 ka pasur një rritje prej 117.576 (m³), krahasuar me vitin 2020.

Fig. 2 Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve (000/ m³)




Në vitin 2021, në fondin pyjor sipërfaqen më të madhe e zënë fletorët me 49,8 %, ndjekur nga të tjera lloje me 35,8 % dhe halorët 14,3 %.

Tab.2 Fondi pyjor sipas strukturës së llojeve (ha)

| Viti / Year | Halorë | Fletorë | Shkure | Pyje Gjithsej |
|-------------|---------|---------|---------|---------------|
| 2019 | 150.912 | 523.907 | 377.024 | 1.051.843 |
| 2020 | 150.911 | 523.907 | 377.023 | 1.051.841 |
| 2021 | 164.524 | 571.166 | 411.034 | 1.146.724 |

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Fig.3 Fondi pyjor sipas strukturës së llojeve, 2021 (%)



Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë, janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ato ofrojnë.

Ato ndahen në 6 kategori sipas rëndësisë:


Tab. 2 Numri dhe sipërfaqja e zonave të mbrojtura

| Kategoria e zonës së mbrojtura | Numri i zonave/(Nr) | | | Sipërfaqja (Ha) | | |
|--|---------------------|------------|------------|-----------------|----------------|----------------|
| | 2019 | 2020 | 2021 | 2019 | 2020 | 2021 |
| Rezervë Strikte Natyrore | 2 | 2 | 2 | 4.800 | 4.800 | 4.800 |
| Park Kombëtar | 14 | 14 | 14 | 230.707 | 230.707 | 230.707 |
| Monument Natyror | 725 | 725 | 725 | 3.470 | 3.470 | 3.470 |
| Rezervat Natyror i Menaxhuar | 25 | 25 | 25 | 169.275 | 169.275 | 169.275 |
| Peizazh i Mbrojtur | 6 | 6 | 6 | 97.333 | 97.333 | 97.333 |
| Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara | 4 | 4 | 4 | 18.245 | 18.245 | 18.245 |
| Gjithsej | 776 | 776 | 776 | 523.831 | 523.831 | 523.831 |

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Zonat e mbrojtura në vitin 2021 zenë një sipërfaqe të përgjithshme prej 523.831/ha duke zënë 30,0 % të sipërfaqes së fondit pyjor dhe rreth 18,0 % të sipërfaqes së përgjithme të vendit. Në vitin 2021 nuk ka patur ndryshime në numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura.

Fig. 4 Struktura e sipërfaqes së zonave të mbrojtura sipas kategorive (%)



Në vitin 2021 sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zenë parqet kombëtare me 44,0 % të sipërfaqes gjithësej ndjekur nga rezervatet natyrore të menaxhuara me 32,3 %, pejsazhet e mbrojtura me 18,6 %, zonat e mbrojtura të menaxhuara 3,5 %, rezervatet natyrore 0,9 % dhe monumente natyrore 0,7 %.

Metodologjia

Të dhënat mbi statistikat e pyjeve dhe biodiversiteti mbështeten në të dhënat administrative me baze vjetore. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve

Sipas Vkm Nr. 433, Datë 8.6.2016 për Transferimin Në Pronësi Të Bashkive Të Pyjeve Dhe Të Kullotave Publike Informacioni mbledhet në të gjitha Bashkitë e vendit të cilat kanë detyrimin ligjor të raportojnë cdo tre muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Baza ligjore për mbledhjen e statistikave të pyjeve dhe biodiversitetit është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Përkufizime

Kadastra e pyjeve: është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

Fond pyjor: janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjët, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

Zonat e Mbrojtura: mund të kenë forma të ndryshme si, park kombëtar, zona të paprekura, zona të ruajtura nga komuniteti, rezervate natyrore dhe rezervate private natyrore. Sipas IUCN, "Një zonë e mbrojtur është një hapësirë gjeografike e mirë përcaktuar, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mënyrave ligjore ose metodave të tjera efektive, që sigurojnë mbrojtjen afatgjatë të natyrës dhe shërbimeve mjedisore të ekosistemeve që lidhen me të, si dhe vlerave kulturore."